

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN
E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË DHE MIRATIMIN E
EMËRIMIT TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË PROPOZUAR NGA “OST”
SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2297/1 prot., datë 21.11.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të propozuar nga “OST”. sh.a.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 147, datë 28.9.2017, miratoi kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe emërimin e tij të propozuar nga “OST” sh.a. dhe me vendimin nr. 103, datë 30.4.2018 miratoi “Programin e Pajtueshmërisë të OST sh.a.”.

- Në zbatim të përcaktimeve të dispozitës nr. 8 të kontratës së miratuar me vendimin nr. 147/2017, rezulton se mandati i Zyrtarit të Pajtueshmërisë së “OST” sh.a., i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 50, më datë 17.2.2021, ka përfunduar.

- ERE, me shkresën nr. 2297 prot., datë 28.10.2024, i kërkoi “OST” sh.a. informacion mbi fazën e procesit të emërimit të Zyrtarit të ri të Pajtueshmërisë.

- OST sh.a., me shkresën nr. 7354 prot., datë 5.11.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2357 prot., datë 6.11.2024), ka depozituar vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë “OST” sh.a. nr. 12, datë 30.10.2024 dhe kontratën e ofrimit të shërbimit të zyrtarit e shoqëruar me shtojcën 1 “Programi i pajtueshmërisë”, i miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 103, datë 30.4. 2018 dhe shtojcën 2 ku përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së zyrtarit.

- Nga sa depozituar nga OST sh.a. vlerësojmë se nuk është dokumentuar plotësisht përmbushja e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 2 të kontratës nga Zyrtari i propozuar, si dhe nuk është detajuar qartësisht përputhshmëria e Zyrtarit të propozuar me kriteret e përcaktuara.

- Për të ruajtur përputhshmërinë e OST-së me detyrimet ligjore dhe për të shmangur çdo vakum institucional që mund të dëmtojë interesat e sektorit, vlerësohet e nevojshme që deri në përfundimin e procesit të miratimit të kontratës dhe emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga ERE, detyrat dhe funksionet përkatëse të vazhdojnë të kryhen nga Zyrtari aktual, i miratuar me vendimin nr. 50/2021 të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe për miratimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të propozuar nga “OST” sh.a.

2. Shoqëria të argumentojë dhe të dokumentojë plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes së Zyrtarit sipas shtojcës II të kontratës së depozituar në ERE.

3. Deri në përfundimin e procesit të miratimit të kontratës dhe emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga ERE, detyrat dhe funksionet përkatëse do të vazhdojnë të kryhen nga Zyrtari aktual, i miratuar me vendimin nr. 50/2021 të Bordit të ERE-s.

4. Drejtoria e Pajtuëshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti